

LIGJ
Nr. 53/2026

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 72/2012 “PËR ORGANIZIMIN
DHE FUNKSIONIMIN E INFRASTRUKTURËS KOMBËTARE TË INFORMACIONIT
GJEOHAPËSINOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Pas pikës 14 të nenit 3 shtohet pika 14/1 me këtë përmbajtje:
“14/1. “Ministri” është ministri përgjegjës për mbrojtjen.”.

Neni 2

Në nenin 6 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në pikën 1 fjalët “në varësi të Kryeministrit” zëvendësohen me fjalët “në varësi të ministrit përgjegjës për mbrojtjen”.
2. Në fund të pikës 3 shtohen fjalët “me propozim të ministrit”.

Neni 3

Pika 2 e nenit 8 ndryshohet si më poshtë:

“2. Drejtori i përgjithshëm i ASIG-ut emërohet, lirohet ose shkarkohet nga Kryeministri me propozim të ministrit.”.

Neni 4

Në pikën 3 të nenit 18 fjalët “i përcjell” zëvendësohen me fjalët “ia përcjell rregullat ministrit për propozim”.

Neni 5

Dispozitë kalimtare

Buxheti i miratuar për vitin 2026 për Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor deri në rishikimin e ligjit nr. 87/2025 “Për buxhetin e vitit 2026” ekzekutohet në strukturën aktuale buxhetore në përputhje me rregullat e legjislacionit buxhetor në fuqi.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 21.5.2026.

Shpallur me dekretin nr. 356, datë 12.6.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.